**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2182/7 prot. Datë 11.10.2023

**V E N D I M**
**Nr.1021/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 11.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK në procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-73920-06-29-2023, me objekt: "Blerje karbon aktiv për UKT Sh.A", me fond limit 60,000,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime, Tiranë.

Skualifikimin e operatorit ekonomik " 2 AT" SHPK dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik "W.Center" SHPK.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "W.Center" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Skualifikimin e operatorit ekonomik "2 AT" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

| | |
|---|---|
| **Ankimues:** | Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr. 8240, Njësia Nr.6, Tiranë<br><br>Operatori ekonomik “W.Center” SHPK me NIPT K63029402A dhe adresë:, Lagjja 8 Shkurti, Pallati 2 katesh, Përballë "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier. |
| **Autoriteti Kontraktor**: | SH.A Ujesjellës Kanalizime Tiranë |
| **Subjekt i interesuar:** | Operatori ekonomik "2 AT" me NIPT K14019001H dhe adresë: Korcë – Dishnicë<br><br>Operatori ekonomik “W.Center” me NIPT K63029402A dhe adresë:, Lagjja 8 Shkurti, Pallati 2 katesh, Përballë "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier. |
| **Baza Ligjore:** | Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi ë *Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.* |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.06.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-73920-06-29-2023, me objekt: "Blerje karbon aktiv për UKT Sh.A", me fond limit 60,000,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 01.08.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 28.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|---|---|---|
| 1. "Albania Distribution Chemicals" SHPK | 49.000.000 lekë | skualifikuar |
| 2. "W.CENTER" SHPK | 51.783.370 lekë | skualifikuar |
| 3. "2 AT" SHPK | 52.400.000 lekë | kualifikuar |

Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike për arsyet si më poshtë:

> *1.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "Albania Distribution Chemicals SH.P.K " me ofertë 49.000.000 (dyzet e nëntë milion) lekë pa tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", VKM-së nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezulton si më poshtë vijon Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon: 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 18.000.000*

*(tetembedhjete milion ) lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcitur nuk përmbush pikën 2.3.1, pika (a) dhe (b), konkretisht vlerën e punës së ngajshme prej 40% të fondit limit sepse nga të gjitha kontratat dhe faturat e paraqitura, specifikisht faturat dhe kontratat e lidhura me sektorin publik, si më poshtë : - Bashkia Kukës me vlerë 790.000 lekë pa tvsh - Bashkia Vorë me vlerë 746.480 lekë pa tvsh - Bashkia e Malësisë së Madhe me vlerë 639.958 lekë pa tvsh - Bashkia Këlcyrë me vlerë 600.000 lekë pa tvsh - Bashkia Gjirokastër me vlerë 749.000 lekë pa tvsh - Bashkia e Malësisë së Madhe me vlerë 780.000 lekë pa tvsh Gjithashtu,në SPE është paraqitur dhe një kontratë e lidhur me Bashkinë Krujë me vlerë 400 .000 lekë pa tvsh, e cila sipas gjykimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është e pavlefshme, pasi objekti i kësaj kontrate është "Blerje produkte anticovid për Bashkinë Krujë" dhe nuk mund të konsiderohen si punë e ngjashme referuar objektit të prokurimit që kërkon të realizojë shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" sh.a. Lidhur me pikën 2.3.1, pika (a), zërat e ngjashëm që përmbushin objektin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor arrijnë vlerën prej 4.305.438 lekë pa TVSH. Vlerë jo e plotë referuar kriterit të sipërcituar. Referuar pikës 2.3.1, pika (b) për punën e ngjashme të realizuar me sektorin privat, opertori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" sh.p.k ka paraqitur 218 fatura, nga të cilat shumë fatura me gjykimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk mund të konsiderohen si punw e ngjashme pasi nuk pewrmbushin karakteristikat e kontratws nw natyrw, kompleksitet dhe metodologji, pasi faturat e paraqitura nga operatori ekonomik si punw tw ngjashme janw gjwrwsisht komponente qw pwrdoren ne fushwn e dezinfektimit dhe pastrimit dhe jo per trajtimin e ujit te pijshem.Gjithashtu, Komisioni i Vlerwsimit tw Ofertave ka vijuar me vlerwsimin e zwrave tw cituar nw faturat e paraqitura nga operatori ekonomik si tw vlefshme ose jo, bazuar nw Vendimin e KPP-sw nr.332/2023. Referuar kwtij vendimi, wshtw bwrw dhe gjykimi i faturave, si mw poshtw :*

*Faturat Tatimore me subjekt privat*

*Nr Nr I faturës Artikulli/Shërbimi Vlera e ngjashme*

*1 48/2022 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*

*2 60/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*

*3 84/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*

*4 96/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*

*5 6/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Fature duplikate*

*6 43/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*7 50/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*8 85/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*9 74/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*10 5/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*11 255/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*12 254/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*13 239/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*14 153/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*15 6/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Fature duplikate*
*16 86/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*17 82/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*18 177/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*19 175/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*20 174/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*21 168/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*22 83/2021 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*23 179/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*24 183/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*25 187/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*26 14/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*27 38/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*28 250/2022 Hipoklorit Kalciumi 30-35% X Lekë*
*29 69/2021/ex050xg548 Hipoklorit Kalciumi 60-70% X Lekë*
*30 9/2022/ex050xg548 Flokulant X Lekë*
*31 149/2022/ex050xg548 flokulant X Lekë*
*32 203/2022/ex050xg548 flokulant X Lekë*
*33 289/2022 flokulant X Lekë*
*34 101/2021 Acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*
*35 112/2021 acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*
*36 145/2022/ex050xg548 acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*
*37 242/2021/ex050xg548 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë*
*38 57/2022 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë*
*39 51/2022/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*40 52/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*41 33/2022/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*42 83/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*43 85/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*44 96/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*45 98/2022 Klor 90% X Lekë*
*46 102/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*47 106/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*48 107/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*49 110/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*

*50 111/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*51 112/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*52 113/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*53 114/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*54 182/2022 Klor 90% X Lekë*
*55 186/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*56 201/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*57 202/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*58 236/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*59 258/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*60 274/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*61 318/2022 Klor 90% X Lekë*
*62 333/2022 Klor 90% X Lekë*
*63 334/2022 Klor 90% X Lekë*
*64 126/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*65 134/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*66 138/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*67 151/2022 Klor 90% X Lekë*
*68 63/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*69 58/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*70 57/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*71 35/2021 Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Sodium Karbonat X Lekë Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë*
*72 41/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 56% X Lekë*
*73 68/2021 Klor 56% X Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*74 14/2021/ex050xg548 Hipoklorit Kalciumi 60-70% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Sodium Karbonat X Lekë Antialge 0 Lekë Flokulant X Lekë*
*75 15/2021 DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë Acid Klorhidrik 33-34% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*76 25/2021 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 90% X Lekë Phenol Red 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Matës PH 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë*
*77 25/2021/ex050xg548 Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë 78 10/ 2021 Sodium Karbonat X Lekë Antialge 0 Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*79 102/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*80 90/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë*
*81 93/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*82 94/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Klor 56% X Lekë Matës PH 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë*
*83 95/2022 Klor 90% X Lekë Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*84 179/2022 Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*

*85 184/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë*
*86 197/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë*
*87 198/2022/ex050xg548 Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë*
*88 165/2022 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 56% X Lekë*
*89 161/2022 Klor 56% X Lekë Klor 90% X Lekë*
*90 218/2022 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë Antialge 0 Lekë*
*91 139/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë DPD no1 0 Lekë Flokulant X Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*92 144/2022 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 56% X Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë*
*93 239/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*94 202/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Klor 90% X Lekë Antialge 0 Lekë Klor 56% X Lekë*
*95 131/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Phenol Red 0 Lekë*
*96 258/2022 Acid Sulfurik 35% 0 Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*97 186/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Acid Sulfurik 35% 0 Lekë*
*98 205/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 90% Tablet X Lekë*
*99 152/2022/ex050xg548 Klor 90% Tablet X Lekë Antialge 0 Lekë*
*100 196/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Phenol Red 0 Lekë DPD no1 0 Lekë*
*101 23/2022/su102tk290 Alkool Etilik Denatyruar 0 Lekë Klor 90% X Lekë*
*102 39/2022/su102tk290 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 90% X Lekë*
*103 80/2023 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*104 61/2023 Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Acid Citrik 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë*
*105 108/2023 Kosh 0 Lekë Tub 0 Lekë Furcë Pastrimi 0 Lekë Antialge 0 Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*106 129/2022 Antialge 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*107 16/2021/ex050xg548 Sles 70% 0 Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*108 65/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Betaine 0 Lekë*
*109 63/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aroma Lavanda 0 Lekë*
*110 60/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*111 105/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*112 125/2022 Acid Acetik 80% 0 Lekë Ujë Oksigjenuar 0 Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*113 32/2021 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Acid Acetik Glacial 99% 0 Lekë*
*114 65/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*115 112/2023 Antialge 0 Lekë*
*116 13/2021 Sodium Bisulfate X Lekë*
*117 6/ 2021 Sodium Bisulfate X Lekë*
*118 237/2022/ex050xg548 Sodium Bisulfate X Lekë*
*119 32/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*

*120 115/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*121 119/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*122 118/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*123 117/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*124 71/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*125 75/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*126 76/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*127 42/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*128 27/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*129 171/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*130 80/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*131 81/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*132 102/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*133 110/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*134 44/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*135 44/2022/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*136 66/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*137 69/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*138 87/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*139 140/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*140 272/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*141 26/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*142 27/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*143 28/2022/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*144 79/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*

*Si rrjedhojë, vlera totale e arrirë me faturat e vlefshme nuk e plotëson vlerën e kërkuar në kriterin e sipërcituar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.*

*Gjithashtu bazuar ne vendimin e KPP –së nr 332/2023 pwr operatorin ekonomik "Albania Distribution Chemicals SH.P.K Bazuar ne VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 40 pika 4 ku thuhet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 30% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për sa më sipër, Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" nuk plotëson pikën 2.3.1, pikën (a) dhe (b), të kapaciteteve teknike për të vërtetuar përvojën e mëparshme të punëve të ngjashme, e cila është një nga kushtet kryesore që provon aftësinë e operatorit ekonomik për kryerjen e shërbimit të kërkuar me qëllim krijimin e bindjes tek AK se operatori ekonomik do ta kryejë me sukses objektin proçedurë prokurimi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.*

*Se dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon: 5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcitur ka paraqitur fletë analize nga Insituti i shëndetit publik . Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuara të gjitha komponentët e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Autoriteti Kontraktor ka specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar. Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP, duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e cila është e paplotë. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik,i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për "Prokurimin Publik", dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

II.4. Në datën 01.09.2023 është publikuar në SPE "Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak" për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 07.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3400 dhe me nr. 2182/2023 prot., datë 07.09.2023 e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si dhe pretendimet mbi verifikimin e dokumentacionit të operatorëve të tjerë ekonomikë

pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, si dhe i kërkon KPP të futet në sistemin e AK, të verifikojë ofertat e vendosura nga operatoret e tjerë ekonomikë konkretisht duke pretenduar:
*"[...]4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara*

*se pari: kriteri: 2.3.1. operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 18.000.000 (tetembedhjete milion ) lekë pa TVSh. për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,*
*b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*
*Arsyet e skualifikimit: nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar nuk përmbush pikën 2.3.1, pika (a) dhe (b), konkretisht vlerën e punës së ngjashme prej 40% të fondit limit sepse nga të gjitha kontratat dhe faturat e paraqitura, specifikisht faturat dhe kontratat e lidhura me sektorin publik, si më poshtë : - bashkia Kukës me vlerë 790.000 lekë pa TVSh - bashkia Vorë me vlerë 746.480 lekë pa TVSh - bashkia e malësisë së madhe me vlerë 639.958 lekë pa TVSh - bashkia Këlcyrë me vlerë 600.000 lekë pa TVSh - bashkia Gjirokastër me vlerë 749.000 lekë pa TVSh - bashkia e malësisë së madhe me vlerë 780.000 lekë pa TVSh gjithashtu, në spe është paraqitur dhe një kontratë e lidhur me bashkinë Krujë me vlerë 400 .000 lekë pa TVSh, e cila sipas gjykimit të komisionit të vlerësimit të ofertave është e pavlefshme, pasi objekti i kësaj kontrate është "blerje produkte anticovid për bashkinë Krujë dhe nuk mund të konsiderohen si punë e ngjashme referuar objektit të prokurimit që kërkon të realizojë shoqëria ujësjellës kanalizime tiranë sh.a. lidhur me pikën 2.3.1, pika (a), zërat e ngjashëm që përmbushin objektin e kërkuar nga autoriteti kontraktor arrijnë vlerën prej 4.305.438 lekë pa TVSh. vlerë jo e plotë referuar kriterit të sipërcituar. referuar pikës 2.3.1, pika (b) për punën e ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik albania distribution chemicalsë sh.p.k ka paraqitur 218 fatura, nga të cilat shumë fatura me gjykimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk mund të konsiderohen si punë e ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji, pasi faturat e paraqitura nga operatori ekonomik si punë të ngjashme janë gjerësisht komponente që përdoren ne fushën e dezinfektimit dhe pastrimit dhe jo per trajtimin e ujit te pijshem. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vijuar me vlerësimin e zërave të cituar në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik si të vlefshme ose jo, bazuar në vendimin e KPP-së nr.332/2023. Referuar këtij vendimi, është bërë dhe gjykimi i faturave. Referuar vendimit të KPP nr. 332/2023, date 03.05.2023, nr. prot.630/8, qe AK ka cituar rezulton se skualifikimi i bërë nga ana e AK është i pabazuar në ligj dhe ne*

*kundërshtim me këtë vendim. sipas vendimit të KPP për procedurën e prokurimit te kryer nga "ujësjellës Kanalizime Durrës" me objekt prokurimi "blerje kimikate" (per trajtimin e ujit) rezulton se artikujt e ngjashëm me mallin objekt prokurimi janë identifikuar qartësisht nga ju si KPP si artikuj per trajtimin e ujit, pra artikuj të cilët janë përfshirë në 218 faturat të dorëzuara nga ana jonë ne SPE në përmbushje të kriterit 2.3.1. për sa i takon kontratës dhe faturës të paraqitur nga ana jonë me Bashkinë Krujë ne i jemi referuar vetëm artikullit hipoklorit natriumi14-15% e artikullit që në bazë të vendimit tuaj si KPP, e keni njohur dhe për më tepër ky është artikull mall prokurimi në procedurën me objekt "blerje kimikate" që AK "Ujë sjellës Kanalizime Tiranë për trajtimin e ujit të pijshëm. Artikujt qe AK kryen si procedure prokurimi per trajtimin e ujit te pijshme ( blerje kimikate ) jane : acid klorhidrik 30-34%, hipoklorit natriumi 14-15%, poliklorur alumini ( flokulant ) ?10% artikujt e njohur nga ju si KPP per te njejtin objekt prokurimi me vendim nr.332/2023, date 03.05.2023, nr. prot.630/8, per proceduren e prokurimit "blerje kimikate per trajtimin e ujit nga autoriteti kontraktor "Ujesjelles Kanalizime Durrës" jane: hipoklorit natriumi, hipoklorit kalciumi, klor 90%, flokulant ( poliklorur alumini ), sodium bisulfat, sode kaustike flakes, klor 90% tablet, sodium karbonat, acid klorhidrik 30-33%, sode kaustike likuid, acid sulfurik. bashkangjitur ne pdf gjeni tabelën me artikujt dhe vlerat përkatëse qe ne kemi paraqitur tek 218 faturat :*

*Sic shihet qartë vlera totale e paraqitur nga ana jonë është 25.959.820,10 ose 43% te fondit limit , pra më e madhe se vlera e kërkuar nga ana e ak, 30% te fondit limit.*

*Pra bie poshtë pretendimi , dhe mos bindja e AK se operatori jone ekonomik nuk mund ta kryeje me sukses objektin procedure prokurimi duke shkelur hapur ligjin e prokurimit publik 162/2020, neni 2, d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

*së dyti: kriteri: 5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara. Arsyet e skualifikimit: se dyti AK ka kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon: 5 .operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur fletë analize nga Instituti i Shëndetit Publik . Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuara të gjitha komponentët e kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Autoriteti kontraktor ka specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standardin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar. Operatori ekonomik Albania Distribution Chemicals" ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP, duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e*

*cila është e paplotë. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Komisioni i vlerësimit të ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për "Prokurimin publik", dhe në mbështetje të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

*Lidhur me pretendimin e AK për këtë arsye skualifikimi në si operator ekonomik kemi tri arsyetime pse pretendimi i AK nuk qëndron:*

*1. Arsyetimi i parë lidhet drejtpërdrejt me Ministrinë e Shëndetësisë, institucioni përgjegjës i cili na pajis ne me autorizim importi (leje importi, ashtu siç është kërkuar në kriterin nr. 4 të DST, vendosur nga AK, kriter të cilin AK e ka pranuar si të plotësuar pa ngritur asnjë pretendim edhe pse ky kriter lidhet drejtpërdrejt më analizën toksikologjike te ISHP, (gjeni bashkangjitur lejen importit) për të importuar dhe nxjerrë në treg këto biocide (hipoklorit natriumi, hipoklorit kalciumi, karbon aktiv etj.) të cilat shërbejnë për përdorim human, saktesisht për trajtimin e ujit të pijshëm.*

*Mbështetur ne sa më sipër ne baze te vendimit nr. 933, date 25.11.2020, "për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg" kreu II, pika 5, faqja 4, në rastet kur përmbushen kërkesat e pikës 4 të këtij kreu, dosja me dokumentacionin teknik ne forme elektronike ( cd ), i dërgohet për vlerësim institutit te shëndetit publik ( ISHP), brenda 25 ditëve nga data e marrjes në dorëzim te dosjes. kreu ii, pika 6, faqja 4, instituti i shëndetit publik (ishp), si strukturë ë specializuar bën vlerësimin e produktit/ve dhe biocid/e bazuar në informacionin e paraqitur në dosje që përfshin: rezultatet e studimeve toksikologjike dhe efektivitetit të lëndës vepruese dhe të përbërësve të tjerë si edhe ndikim në mjedis, simbolet, frazat e rriskut dhe sigurisë, klasifikimin, etiketimin dhe paketimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet dhe biocidet si dhe dokumentin e të dhënave të sigurisë së kimikateve (msds) shtojca 1, "Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide". kreu I, pika 7, pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, Instituti i Shëndetit publik, përgatit raportin e vlerësimit për vendosjen në treg të produktit biocid dhe e dërgon atë pranë sekretariatit brenda 30 ditëve. Mbështetur ne sa më sipër ne i jemi drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me dokumentacionet përkatëse për karbonin aktiv, për tu pajisur me leje importi. Ministria e Shëndetësisë i është drejtuar Institutit të Shëndetit publik (ISHP), i autoriteti i vetëm i specializuar për vlerësimin e këtij produkti nëpërmjet analizës toksikologjike (vetëm me ato 4 parametra që ISHP mund të analizojë) nëse plotëson kushtet për përdorim human apo jo, dhe në varësi të përgjigjes së analizës së ISHP, Ministria e Shëndetësisë na pajis ne më autorizimin për të importuar dhe për ta tregtuar në tregun vendas me qëllim përfundimtar përdorim human. Mbështetur në këtë arsyetim pretendimi i AK është i pavlefshëm pasi ISHP me anë të analizës që i jep*

*Ministrisë së Shëndetësisë të drejtën për të na pajisur në me leje importi (gjeni bashkëlidhur). Ak nuk ka tagrin ligjor të kundërshtojë një analizë toksikologjike dhe vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat nëpërmjet kësaj analize konfirmojnë që malli përmbush parametrat e kërkuara në Republikën e Shqipërisë dhe na lejojë ne ta tregtojmë këtë mall brenda vendit për përdorim human, theksojmë se marrëdhënie tregtare është prokurimi publik. 2. Arsyetimi i dytë lidhet drejtpërdrejt me të parin, pasi ndër vite ISHP ka bërë të njëjtën analizë për karbonit aktiv dhe AK nuk ka ngritur ndonjëherë këtë pretendim që kjo analizë është e paplotë për fituesit e viteve më parë (kërkojmë nga ju të verifikohen fletë-analizat e dorëzuara nga operatorët fitues për vitet 2021-2020-2019-2018-2017). Analizën e ISHP ky AK e ka pranuar gjithmonë pasi në Republikën e Shqipërisë është i vetmi autoritet i specializuar sikurse thekson edhe Ministria e Shëndetësisë. Kjo pasi AK nuk mund të dalë sipër autoriteteve që kanë të drejtë të shprehen lidhur më parametrat që plotëson ky produkt dhe të marrë kompetenca që si takojnë duke u shprehur mbi ISHP dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Thënë kjo AK ka vepruar në mënyrë të qëllimshme duke përdorur këtë arsyetim të pabazë dhe në kundërshtim të hapur me veten dhe autoritetet përgjegjëse të përcaktuar me ligj, pasi qëllimi i tyre është të gjenin një shkak për skualifikim e operatorit tonë ekonomik. Për sa më sipër ndihemi të diskriminuar dhe të trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga AK dhe për këtë arsye ju si KPP duhet të merrni masa sipas ligjit ne fuqi.*

*3. Arsyetimi i tretë është një vendim nr. 888/2022, date 14.09.2022, nr. prot 1779/6, faqja 8-te, ju si KPP thoni qartë se citojmë : "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në cdo rast këto specifikime teknike dhe kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustifikuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar mbështetur në sa më sipër laboratori i vetëm i cituar me emër nga AK është Instituti i Shëndetit Publik ( sepse analizën e ISHP ka pranuar gjithmonë pasi në Republikën e Shqipërisë është i vetmi autoritet i specializuar sikurse thekson edhe Ministria e Shëndetësisë) ndërkohë për laboratorët e tjerë AK nuk na ka referuar asnjë laborator konkret. Thënë kjo mbështetur edhe në vendimin e KPP të sipër cituar ne i jemi referuar laboratorit të përmendur me emër nga AK dhe mbi të gjitha një laboratori që njihet me ligj në Republikën e Shqipërisë dhe që AK e ka pranuar në çdo procedure prokurimi me objekt "blerje kimikate" dhe "blerje karbon aktiv". Kurse pikërisht në këtë procedure pas 28 ditësh vlerësimi të ofertave ngrihet ky pretendim, duke marrë kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoriteti i vetëm që jep lejë për biocidet që plotësojnë parametrat që duhet të tregtohen në vend me qëllim final përdorimin human.*

*4. Arsyetimi i fundit lidhet me mostrën që në kemi dorëzuar ditën e hapjes së ofertave, datë 01.08.2023 ne baze te kriterit: 8.operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si me poshtë: 1.karbon aktiv mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*

*Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. datën e hapjes së ofertave ne kemi dorëzuar mostrën e mallit objekt prokurimi. mostra që operatorët ekonomikë dorëzojnë i nënshtrohet analizave të ak, se ndryshe për çfarë arsye kërkohet?! mbështetur në këtë fakt për sa kohë AK nuk ka ngritur si pretendim për skualifikim faktin së mostra nuk i përmbushte*

*parametrat e kërkuara atëherë mostra ka rezultuar brenda parametrave të kërkuara AK dhe AK qëllimisht ka anashkaluar këtë fakt duke kërkuar arsye të paqena në një analizë që ligjërisht njihet nga Republika e Shqipërisë dhe përmbush të gjitha kushtet që institucionet përgjegjëse ( Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP) kanë vendosur për të kualifikuar një biocid sipas parametrave ose jo.*

*së treti: Ne si operator ekonomik kërkojmë që të verifikohen dokumentacioni e operatorë ve të tjerë ekonomik pjesë marrë në këtë procedurë . Gjithashtu kërkojmë te futeni ju si KPP ne sistemin e AK, të verifikoni ofertat e vendosura nga operatoret e tjerë ekonomik sepse ka patur modifikim dhe vendosje e dy ofertave nga secili operator ekonomik, duke nxjerrë nga AK vetëm ofertën më të ulët ekonomike nga këta operatorë .*

*Në përfundim: thënë kjo nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve AK qëllimisht kërkon të na skulifikojë duke dalë në kundërshtim me veten dhe procedurat që ka ndjekur ndër vite, për të favorizuar një operator të caktuar ashtu sikurse ne e kemi parashikuar me denoncimin qe i jemi drejtuar pranë struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) që në fillim kur është publikuar procedura në sistem.*
*Kjo ankesë do të paraqitet si informacion shtese pranë Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ( SPAK ) se bashku me gjithë korrespodencën qe kemi patur gjate gjithë kësaj periudhë me AK-në duke qenë të vetëdijshëm që ankesa jonë nuk do të pranohet nga AK duke ju referuar qëndrimit të tyre në korrespondencat mes nesh, kërkojmë nga e KPP që ankesa jonë të pranohet sepse AK ka shkelur hapur ligjin e LPP dhe vendimet qe ju i keni dhene njehere po per te njejten procedure objekt prokurimi.*"

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2182/2 prot., datë 07.09.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK dhe pretendimeve mbi operatorët e tjerë.

II.7 Me datë 08.09.2023 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar me tonën nr. 2182/3 prot., datë 08.09.2023 si dhe me datë 08.09.2023 përmes shërbimit postar protokolluar me tonën nr. 2182/4 prot., datë 11.09.2023, operatori ekonomik "2AT" SHPK ka paraqitur pranë KPP-së formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" duke argumentuar si më poshtë:
"*Firma 2 AT ShPK me NIPT K14019001 H , ka marre pjese ne proceduren e prokurimit me objekt "Blerje Karbon Aktiv për UKT " sh.a, date 0110812023 me Nr. Ref-73920-06-29-2023 ku jemi kualifikuar si operator ekonomik duke permbushur te gjitha kriteret sipas dokumenteve standarde te tenderit dhe kemi marre njoftim ne daten 0110912023 ne sistemin elektronik Formular i njoftimit te operatoreve ekonomike e suksesshem ne marreveshjen kuader paraprak referuar VKM 807 date 11.06.2016 Firma 2 AT ShPK kundershton pretendimet e operatorit ekonomik Albania Distribution Chemicals ne ankesen e bere nga kjo*

*firme me Nr aplikimi të ankesës online: A/2023/3400, Nunmrri i Protokollit 2182/2023, Data e Protokollit 2023-09-07. Firma 2 AT shpk, NIPT K14019001H e vlereson te drejte skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar Firma 2AT Shpk me NIPT K14019001H e vlereson te drejte skualifikimin e ketij OE pasi ai nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika 2.3*

*Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim pika :*

*2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:*

*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 99 të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 18.000.000 (tetembedhjete milion ) lekë pa TVSh.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*Kjo pike nuk eshte permbushur nga ky operator pasi nuk ka paraqitur dhe nuk ploteson vleren 30 % te furmizimeve te mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës pasi faturat e paraqitura nga ky operator permbajne artikuj te ndryshem te cilet nuk janë me te njejten natyre me produktin e kerkuar ne baze te objektit te kontrates "Blerje Karbon Aktiv për UKT " sh.a, Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik. Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë.*

*Artikujt ne faturat e paraqitura nuk jane kimikate per trjatimin e ujit te pijshem per konsum njerezor kjo duket qarte nga FORMULARI PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË, Nr.2182/2 prot., Datë 07.09.2023 .*

*Pra kimikatet e paraqitura jane kimikate jo te perdorshme per trajtimin e ujit te pijshem prandaj keto nuk duhet te merren parasysh si fumizime te ngjashme per kete procedure prokurimi, e permendur dhe ne Vendimin e Nr.332/2023 date 03.05.2023 me nr. 630/8 prot te KPP.*

*Firma 2AT Shpk me NIPT K14019001H e vlereson te drejte skualifikimin e ketij OE pasi ai nuk ka permbushur Kriteret e Veçanta te Kualifikimit pika 5*

*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*

*SPECIFIKIMET TEKNIKE*

*Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur*
*Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.*
*Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të permbushin parametrat si më poshtë :*

*Nr. Parametrat Njësia matjes Specifikimet Metoda*

*1 Densiteti dukshëm Kg/m3 200 — 750 SSH EN 12902: 2006*

*2 Granulometria 150m, % në m/m min. 95 SSH EN 12902: 2006*

*3 Hiri % m/m max. 15 SSH EN 12902: 2006*
*4 Lagështia(ne ambalazhim ) % në m/m max. 5 SSH EN 12902: 2006*

*5 Nr Jodit mg/g min 900 SSH EN 12902: 2006*

*6 Substancat e tretshme ne uje % në m/m max. 3 SSH EN 12902: 2006*
*7 Zinku (Zn) % në m/m max. 0.002 SSH EN 12902: 2006*
*8 Arseniku (As) mg/kg max.10 SSH EN 12902: 2006*

*9 Kadmiumi (Cd) mg/kg max. 5 SSH EN 12902: 2006*

*10 Krom (Cr) mg/kg max.50 SSH EN 12902: 2006*
*11 Merkur (Hg) mg/kg max. 1 SSH EN 12902: 2006*
*12 Nikel (Ni) mg/kg max.20 SSH EN 12902: 2006*
*13 Plumb (Pb) mg/kg max.10 SSH EN 12902: 2006*
*14 Antimoni ( Sb) mg/kg max. 5 SSH EN 12902: 2006*
*15 Selenium (Se) mg/kg max.10 SSH EN 12902: 2006*
*16 Jone Cianur (CN-) mg/kg max.50 SSH EN 12902: 2006*
*17 PAH mg/kg max. 0.2 SSH EN 12902: 2006*

*Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standartin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902: 2006.*

*Operatorit ekonomik Albania Distribution Chemicals nuk ka plotesuar kete pike pasi ka paraqitur vetem analizen ISHP, duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar.*

*Kjo analize konsiderohet e paplotë pasi ka vetem kater parametra te analizuar nga 17 parametra qe kerkoheshin nga Autoriteti Kontraktor per artikullin Karbon Aktiv .*

*Firma 2 AT Shpk me NIPT K14019001H e vlereson jo te drejte vleresimin e Autoritetit Kontraktor per Kriteret e Veçanta te Kualifikimit pika 11*

*11. Operatori ekonomik duhet te paraqese:*

*Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
*duke e marre te mireqene dhe te drejte Autorizimin e Prodhuesit kjo duke u bazuar nga komunikimi qe ka patur Autoriteti Kontraktor me OE Albania Distribution Chemicals ne faqen e APP ne Kerkesat (bashkangjitur keni komunikimin ne sistemin e APP ne kerkesat nëpërmjet Autoritetit Kontraktor dhe me OE Albania Distribution Chemicals Vihet re qarte nga ky komunikim se firma prodhuese e Karbonit Aktiv eshte SIVAC s.p.a e cila ka autorizuar per shitje karboni firmën ALLCHITAL s.r.1 dhe kjo e fundit ka autorizuar OE Albania Distribution Chemicals. Kerkesa e Autoriteti Kontraktor i eshte bere firmes SIVAC s.p.a dhe eshte refuzuar nga SIVAC s.p.a per te konfirmuar nqs Autorizimi eshte i vlefshem apo jo. Gjithashtu bie ndesh komunikimi ndermjet OE Albania Distribution Chemicals dhe firmes SIVAC s.p.a pasi kjo firme nuk ka leshuar asnje autorizim per OE Albania Distribution Chemicals. Firmes SIVAC s.p.a i eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktor qe te konfirmoje vertetesine e Autorizimit qe i eshte dhene firmes ALLCHITAL s.r.1.*
*Autoriteti Kontraktor nuk duhet ta mare te mireqene plotesimin e kesaj pike nga OE Albania Distribution Chemicals. Kerkojme nga ana juaj verifikimin e ketyre dokumenteve dhe autorizimeve te paraqitura nga OE Albania Distribution Chemicals te firmave :*
*SIVAC s.p.a*
*ALLCHITAL s.r.1*
*Pasi mendiojme qe keto dokumente jane te pasakta dhe te rreme. Per sa i perket pretendimit te operatorit ekonomik Albania Distribution Chemicals per verifikimin e ofertave ne sistemin e APP te dorezuar ne kete procedure prokurimi jemi dakort qe te behet ky verifikim.*"

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 9352/17 prot., datë 18.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2158/5 prot., datë 20.09.2023 me objekt "*Informacion mbi ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Karbon aktiv për UKTT sh.a"*, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontrakor nuk e ka pranuar

ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK duke argumentuar si më poshtë: “[...] *Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor kundërshton skualifikimin e tij nga procedura objekt ankimi. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim procesverbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO vëren se operatori ekonomik është skualifikuar me arsyetimin e mëposhtëm:*
*Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:*

*2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:*

*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion ) lekë pa TVSh.*
*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin*
*dëshmitë e mëposhtme:*

*a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të-shënohen-vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,*
*ose*
*b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*
*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me pikën 2.3.1, pika (a), zërat e ngjashëm që përmbushin objektin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor arrijnë vlerën prej 4.305.438 lekë pa TVSH. Vlerë e cila nuk përmbush kriterin e sipercituar .*
*Referuar pikës 2.3.1, pika (b) për punën e ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k ka paraqitur 146 fatura (dy janë me vlerë përfundimtare zero) një pjesë dërmuese e të cilave me gjykimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nuk mund të konsiderohen si punë e ngjashme pasi faturat e paraqitura nga operatori — ekonomik janë gjerësisht komponentë që përdoren ne fushën e dezinfektimit dhe pastrimit dhe jo për trajtimin e ujit të pijshëm.*
*Së pari në formularin e ankesës të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik citon se vlera e paraqitur nga ana e tij është 25.959.820,10 ose 43% e fondit limit, vlerë kjo me e madhe se vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor, si dhe për sa i përket kontratës dhe faturave me “Bashkine Krujë” i jemi referuar vetëm zërit Hipoklorit Natriumi 14-152 %.*
*Komisioni i shqyrtimit të ankesave, ju bën me dije, se komisioni i vlerësimit të ofertave ka vijuar me procesin e vlerësimit të ofertave duke shqyrtuar të gjithë faturat e operatorit*

*ekonomik, sipas tabelës bashkëlidhur, duke bërë ndarjen e artikujve të cilët përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm dhe artikujve të cilët janë llogaritur me vlerë zero pasi janë komponentë të cilët përdoren kryesisht në fushën e dezinfektimit dhe pastrimit dhe nuk përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm, siç janë zërat që kërkohen në objektin e procedurës së prokurimit. Artikujt të cilët janë konsideruar të vlefshëm dhe përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm. arrijnë vlerën 14.565.058,77 lekë pa TVSH.*

Faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ne SPE jane sipas tabeles me poshte:

*Nr Nr I faturës Artikulli/Shërbimi Vlera e ngjashme*
*1 48/2022 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*
*2 60/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*
*3 84/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*
*4 96/2021 Sodë Kaustike Liquid X Lekë*
*5 6/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Fature duplikate*
*6 43/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*7 50/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*8 85/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*9 74/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*10 5/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*11 255/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*12 254/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*13 239/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*14 153/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*15 6/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Fature duplikate*
*16 86/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*17 82/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*18 177/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*19 175/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*20 174/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*21 168/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*22 83/2021 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*23 179/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*24 183/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*25 187/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*26 14/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*27 38/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*28 250/2022 Hipoklorit Kalciumi 30-35% X Lekë*
*29 69/2021/ex050xg548 Hipoklorit Kalciumi 60-70% X Lekë*
*30 9/2022/ex050xg548 Flokulant X Lekë*
*31 149/2022/ex050xg548 flokulant X Lekë*
*32 203/2022/ex050xg548 flokulant X Lekë*
*33 289/2022 flokulant X Lekë*
*34 101/2021 Acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*
*35 112/2021 acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*
*36 145/2022/ex050xg548 acid Klorhidrik 33-34% X Lekë*

*37 242/2021/ex050xg548 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë*
*38 57/2022 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë*
*39 51/2022/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*40 52/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*41 33/2022/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*42 83/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*43 85/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*44 96/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*45 98/2022 Klor 90% X Lekë*
*46 102/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*47 106/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*48 107/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*49 110/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*50 111/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*51 112/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*52 113/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*53 114/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*54 182/2022 Klor 90% X Lekë*
*55 186/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*56 201/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*57 202/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*58 236/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*59 258/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*60 274/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*61 318/2022 Klor 90% X Lekë*
*62 333/2022 Klor 90% X Lekë*
*63 334/2022 Klor 90% X Lekë*
*64 126/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*65 134/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*66 138/2021/ex050xg548 Klor 90% X Lekë*
*67 151/2022 Klor 90% X Lekë*
*68 63/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*69 58/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*70 57/2023/su102tk290 Klor 90% X Lekë*
*71 35/2021 Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Sodium Karbonat X Lekë Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë*
*72 41/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 56% X Lekë*
*73 68/2021 Klor 56% X Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*74 14/2021/ex050xg548 Hipoklorit Kalciumi 60-70% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Sodium Karbonat X Lekë Antialge 0 Lekë Flokulant X Lekë*
*75 15/2021 DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë Acid Klorhidrik 33-34% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*76 25/2021 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 90% X Lekë Phenol Red 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Matës PH 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë*

*77 25/2021/ex050xg548 Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë 78 10/ 2021 Sodium Karbonat X Lekë Antialge 0 Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*79 102/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*80 90/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Antialge 0 Lekë*
*81 93/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*82 94/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Klor 56% X Lekë Matës PH 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë*
*83 95/2022 Klor 90% X Lekë Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*84 179/2022 Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*85 184/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë*
*86 197/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë*
*87 198/2022/ex050xg548 Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë*
*88 165/2022 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 56% X Lekë*
*89 161/2022 Klor 56% X Lekë Klor 90% X Lekë*
*90 218/2022 acid Klorhidrik 30-33% X Lekë Antialge 0 Lekë*
*91 139/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë DPD no1 0 Lekë Flokulant X Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*92 144/2022 Klor 90% Tablet X Lekë Klor 56% X Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë*
*93 239/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë*
*94 202/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Klor 90% X Lekë Antialge 0 Lekë Klor 56% X Lekë*
*95 131/2022 Klor 90% X Lekë Klor 56% X Lekë Flokulant X Lekë Antialge 0 Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Phenol Red 0 Lekë*
*96 258/2022 Acid Sulfurik 35% 0 Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*97 186/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Acid Sulfurik 35% 0 Lekë*
*98 205/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 90% Tablet X Lekë*
*99 152/2022/ex050xg548 Klor 90% Tablet X Lekë Antialge 0 Lekë*
*100 196/2022/ex050xg548 Klor 90% X Lekë Phenol Red 0 Lekë DPD no1 0 Lekë*
*101 23/2022/su102tk290 Alkool Etilik Denatyruar 0 Lekë Klor 90% X Lekë*
*102 39/2022/su102tk290 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Klor 90% X Lekë*
*103 80/2023 Klor 90% X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Flokulant X Lekë Acid Citrik 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*104 61/2023 Klor 56% X Lekë Klor 90% Tablet X Lekë Sodium Bisulfate X Lekë Acid Citrik 0 Lekë Sodium Karbonat X Lekë*
*105 108/2023 Kosh 0 Lekë Tub 0 Lekë Furcë Pastrimi 0 Lekë Antialge 0 Lekë Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë Klor 56% X Lekë*
*106 129/2022 Antialge 0 Lekë DPD no1 0 Lekë Phenol Red 0 Lekë Matës PH 0 Lekë*
*107 16/2021/ex050xg548 Sles 70% 0 Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*108 65/2022 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Betaine 0 Lekë*

*109 63/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aroma Lavanda 0 Lekë*
*110 60/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*111 105/2022/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*112 125/2022 Acid Acetik 80% 0 Lekë Ujë Oksigjenuar 0 Lekë sodë Kaustike Flakes 0 Lekë*
*113 32/2021 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Acid Acetik Glacial 99% 0 Lekë*
*114 65/2021/ex050xg548 sodë Kaustike Flakes 0 Lekë Aromë Limoni 0 Lekë*
*115 112/2023 Antialge 0 Lekë*
*116 13/2021 Sodium Bisulfate X Lekë*
*117 6/ 2021 Sodium Bisulfate X Lekë*
*118 237/2022/ex050xg548 Sodium Bisulfate X Lekë*
*119 32/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*120 115/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*121 119/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*122 118/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*123 117/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*124 71/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*125 75/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*126 76/2021/ex050xg548 Klor 56% X Lekë*
*127 42/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*128 27/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*129 171/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*130 80/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*131 81/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*132 102/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*133 110/2021/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*134 44/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*135 44/2022/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*136 66/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*137 69/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*138 87/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*139 140/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*140 272/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*141 26/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*142 27/2022 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*143 28/2022/ex050xg548 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*
*144 79/2021 Hipoklorit Natriumi 14-15% X Lekë*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vijuar me vlersëimin duke ju referuar dhe Vendimit të KPP-së me NR. 332/2023 lidhur me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje kimikate" ku palë ankimuese është operatori ekonomik "Albvania Disribution Chemicals" dhe palë e paditur Autoriteti Kontraktor "Ujësjellës Kanalizime Durrës" sh.a si Rekomandimit të Organizatës Botërore të Shëndetsisë dhe Rregullores 528 /2012 duke dalë në përfundimin arrirë nga operatori ekonomik lidhur me piken 2.3 1 pika (a) është 4.447.4738 vlerë kjo e cila nuk përmbush vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor duke shtuar dhe vlerën e zërit të Hipoklorit Natriumi 14-15% në kontratën e lidhur me "Bashkinë Krujë".*

*Për sa i përket pikës 2.3.1 pika (b) vlera totale e të gjithë faturave të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimeve është 19.098.825,43 lekë pa TVSH. Komisioni i shqyrtimit të ankesave, bazuar në vlerësimin e bërë nga Komisioni 1 Vlerësimit të Ofertave vëren se vlera totale e zërave të ngjashëm me objektin e procedurës së prokurimit është 14.565.058,77 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur do të gjeni tabelën me lëndët kimikate që përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm të cilit i janë referuar*

| *Lënda kimike* | *Numri CAs* | *Lenda aktive* | *Veprimi* | *Përqëndrimi* | *Standardi* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Hipoklorit CA kokrrizor* | *7778-54-3* | *Klor aktiv* | *Dezinfektatnt* | *60-70* | *SSH:EN-900;2007* |
| *Hipoklorit Na* | *7681-52-9* | *Klor aktiv* | *Dezinfektant* | *13-5* | *SSH:EN-900;2007* |
| *Tretesire hipokloriti prodhuar in situ* | *7782-50-5* | *Klor aktiv* | *Dezinfektant* | *0.05-0.07* | |
| *Acid sulfurik* | *7664-93-9* | *Acid sulfurik* | *Rregullues i PH* | *98* | *SSH:EN-899;2009* |
| *Acid Klorhidrik* | *7647-01-0* | *Acid klorhidrik* | *Rregullues i pH* | *25-38* | *SSH:EN-939;2009* |
| *Karbon aktiv pluhur* | *7440-44-0* | *Karbon aktiv* | *Adsorbues* | | *SSH:EN-12903;2009* |
| *Karbon aktiv kokrrizor* | *7440-44-0* | *Karbon aktiv* | *Adsorbues* | | *SSH:EN-12915-1;2009* |
| *Poliklorur alumini tretesire* | *1327-41-9* | $Al_2O_3$ | *Koagulant* | *10-14* | *SSH:EN-883:2003* |

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren, se vlera e cituar nga operatori ekonomik ankimues përkatësisht 25.959.820,10 është vlerë e cila përfshin punën e ngjashme me sektorin publik dhe privat së bashku.*
*Si përfundim, komisioni i shqyrtimit të ankesave, bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 39, Pika 5 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" citohet se: "Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme për prokurimin publik", do të konsiderohej e vlefshme nëse operatori ekonomik ankimues do të plotësonte kriterin e sipërcituar me njërën nga pikat (a) ose (b) duke qene se secila pune e ngjashme (sektori publik apo privat ) përllogariten me vete.*
*Komisioni i shqyrtimit të ankesave e gjykon të saktë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.*

*Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon:*

*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*
*Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur fletë analize nga Instituti i shëndetit publik .*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuara të gjitha komponentët e kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Autoriteti Kontraktor ka: specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standardin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar. Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e cila është e paplotë.*

*Së dyti në formularin e ankesës operatori ekonomik pretendon laboratori i vetëm i cituar me emër nga AK është Instituti i Shëndetit Publik, ndërkohë për laboratorët e tjerë AK nuk ka referuar asnjë laborator konkret.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se, referuar kriterit të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, ka sqaruar se fletë analiza që duhej të paraqitej nga operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të përmbajë parametrat e sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009),të cilat mund të jenë të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*
*Komisioni i shqyrtimit te ankesave ju bën me dije se Autoriteti kontraktor lidhur me kriterin e Sipërcituar, duke mos cituar emra për laboratorët kombëtarë ose ndërkombëtarë të akredituar, u ka lënë hapësirë operatorëve ekonomik pjesëmarrës të bëjnë zgjedhjet e tyre për të plotësuar zërat e analizuar të parametrave të sigurisë që nuk mbulohen nga Instituti i Shëndetit Publik në laboratorët që ata dëshirojnë me qëllim përmbushjen e kriterit të kërkuar nga Autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, por me kushtin që të jenë të akredituar për të përmbushur standardin S SH EN 12903: 2009.*
*Komisioni i shqyrtimit të Ankesave sqaron se, në rast se operatori pjesëmarrës do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 17/1 e LPP, ku parashikohet se:*

*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, për shirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*".

*Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës , do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Sqarojmë se përderisa operatori ekonomik Albania Distribution Chem sh.p.k nuk e ka ushtruar të drejtën e kërkesës për sqarim apo të drejtën e ankimit brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e APP-së lidhur me vendosjen e kritereve te veçanta të kualifikimit atëherë është i detyruar që në fazën e vlerësimit të ofertave të plotësojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST. Pra në vlerësimin e një procedure prokurimi vlerësohet vetëm mbi bazë të kritereve të kërkuara në DST.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme ekonomiko-financiare, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave e gjykon të saktë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron*."

II.9. Me datë 21.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 2182/6 prot., operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me përmbajtje si vijon: "[...] *Në përgjigjen që kemi marrë Autoriteti Kontraktor duket qartë që do të favorizojë qëllimisht operatorin ekonomik "2AT" SHPK që në krye të herës me kriteret që u vendosen (ashtu siç e kemi parashikuar edhe tek Denoncimi qe ju kemi paraqitur qe kemi bere pranë SPAK.)*

*Së pari autoriteti kontraktor vazhdon të mos njohe vendimet tuaja si KPP ku ju jeni shprehur njehere ne lidhje me kete kriter me vendimin, per proceduren e prokurimit "Blerje kimikate" per trajtimin e ujit te pijshëm të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor "Ujësjellës Kanalizime Durrës" keni dale me vendim duke njohur disa prej artikujve qe ne kemi paraqitur ne faturat tone.*

*Ne kemi vendosur te njejtat artikuj qe ju keni njohur ne procedure me te njëjtin objekt mall objekt prokurimi. Per kete arsye eshte e kote qe t'ju riperserisim argumentet tona qe kemi paraqitur ne ankesen me nr ?*

*Se dyti: Perpara se tjau argumentojme perseri kjo flete analize qe duhet te paraqitej ne kete procedure nuk ka asnje vlere sepse malli ne momentin e dorezimit analizohet perseri nga AK.*

*Ne shtojcën 5 te DST thuhet se: Në ditën e dorëzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të paktën 4 kampione të cilat do të futen në cnë të përshtatshme, të vulosen dhe firmosen nga marrësi dhe transportuesi, dhe nga të cilat një do ti dorëzohet nëpërmjet*

*autotrasportuesit firmës furnizuese dhe katër laboratorit fiziko - kimik të Impiantit Bovillë për analiza c verifikime përkatësisht për përcaktimin e parametrave cilësor e konkretisht të densitetit të dukshëm, numrit të jodit, hirit, lagështisë, substancave të tretshme në ujë duke mos realizuar për arsye objektive granulometrinë .Nje kampion do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtimesh nga ana e Shoqërisë furnizuese. Në një situatë të tillë të dy palët do të ndjekin bashkërisht kontrollin e analizave pranë laboratorit të Ujësjellësit mbi kampionin e katërt të vulosur si dhe mbi atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi të nuk është vënë dorë, e ti nënshtrohen marrëveshjes së arsyeshme Në këto kushte ky kriter nuk përbën kusht për skualifikim pasi malli do t'i nënshtrohet sërisht analizave në momentin e dorëzimit, dhe çfarëdo analizë të dorëzohet në këtë fazë është e parëndësishme në rast se malli nuk plotëson parametrat në momentin e lëvrimit të tij. 5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara.*

*1. AK ne përgjigje te kriterit te mësipërm thote se : ka sqaruar se flete analiza qe duhet te paraqitet nga operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet të përmbajë parametrat e sigurisë sipas (S SH EN 12903:2009) të cilat mund të jenë të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ( faqja 11 e përgjigjes së AK ). AK në këtë rast gënjen hapur për të justifikuar skualifikimin tonë, sepse AK ka kërkuar në kriterin citojmë më poshtë: Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara. AK ka kërkuar në DST shprehimisht flete analizën e parametrave të sigurisë të analizuara në Institutin e Shendetit Publik, jo siç pretendon në argumentet e përgjigjes së saj "parametrat e sigurisë sipas (S SH EN 12903:2009) të cilat mund të jenë të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik". Nga përgjigja e tyre e cila tenton të tjetërsojë përmbajtjen e DST të cilën ata vetë kanë publikuar, kërkojnë të stisin një arsye pa arsye për të skualifikuar operatorin tonë ekonomik. 2. Ju me Nr. Vendim 888/2022, Date 14.09.2022 , keni cituar se: "Për sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë bazuar edhe në përgjigjen e ISHP-së se për cilët tregues duhet të kërkojë analizën toksikologjike nga ana e ISHP dhe për analizat toksikologjike që nuk kryhen nga ISHP autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu në përcaktimin e këtyre organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre lloj analizash toksikologjike. Citojmë përsëri "duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre lloj analizash toksikologjike", atehere ne pervojat e meparme qe ky AK ka pranuar per kete analize ka qene gjithmone Analiza e ISHP-se (jeni te lutur ti kerkoni AK tju paraqesë flete analizat qe ka pranuar nder vite per "Blerje Kimikate" dhe "Blerje Karbon Aktiv".*

*3. Arsyetimi tjeter lidhet drejtpërdrejt me Ministrinë e Shëndetësisë, institucioni përgjegjës i cili na pajis ne me Autorizim Importi (leje importi, ashtu sic është kërkuar në kriterin Nr. 4 të DST, vendosur nga AK, kriter të cilin AK e ka pranuar si të plotësuar pa ngritur asnjë pretendim edhe pse ky kriter lidhet drejtpërdrejt më analizën toksikologjike te ISHP, gjeni*

*bashkangjitur lejen importit ) për të importuar dhe nxjerrë në treg këto biocide ( Ilipoklorit Natriumi, Hipoklorit Kalciumi, Karbon Aktiv etj)) të cilat shërbejnë për përdorim human, saktesisht për trajtimin e ujit të pijshëm. Mbështetur ne sa më sipër ne baze te Vendimit Nr 933, date 25.11.2020, "Për përcaktimin c rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve Biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg" Kreu II, Pika 5, faqja 4, në rastet kur përmbushen kërkesat e pikës 4 të ketij kreu, dosja me dokumentacionin teknik ne forme elektronike ( CD ), 1 dërgohet për vlerësim Institutit te Shëndetit Publik ( ISHP ), brenda 25 ditëve nga data e marrjes në dorëzim te dosjes. Kreu II, Pika 6, faqja 4, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), si strukturë ë specializuar bën vlerësimin e produktit/ve dhe biocid/e bazuar në informacionin e paraqitur në dosje që përfshin: rezultatet e studimeve toksikologjike dhe efektivitetit të lëndës vepruese dhe të përbërësve të tjerë si edhe ndikim në mjedis, simbolet, frazat e rriskut dhe sigurisë, klasifikimin, etiketimin dhe paketimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet dhe biocidet si dhe dokumentin e të dhënave të sigurise së kimikateve (MSDS) Shtojca I, "Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide". Kreu I, pika 7, Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, Instituti i Shëndetit Publik, përgatit Raportin e vlerësimit për vendosjen në treg të produktit biocid dhe e dërgon atë pranë Sekretariatit brenda 30 ditëve. Mbështetur ne sa më sipër ne i jemi drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me dokumentacionet përkatëse për Karbonin Aktiv, për tu pajisur me leje importi. Ministria e Shëndetësisë i është drejtuar Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), 1 autoriteti 1 vetëm 1 specializuar për vlerësimin e këtij produkti nëpërmjet analizës toksikologjike (vetëm me ato 4 parametra që ISHP mund të analizojë) nëse plotëson kushtet për përdorim human apo jo, dhe në varësi të përgjigjes së analizës së ISHP, Ministria e Shëndetësisë na pajis ne më autorizimin për të importuar dhe për ta tregtuar në tregun vendas me qëllim përfundimtar përdorim human. Mbështetur në këtë arsyetim pretendimi i AK është i pavlefshëm pasi ISHP me anë të analizës që i jep Ministrisë së Shëndetësisë të drejtën për të na pajisur në me leje importi (gjeni bashkëlidhur). AK nuk ka tagrin ligjor të kundërshtojë një analizë toksikologjike dhe vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat nëpërmjet kësaj analize konfirmojnë që malli përmbush parametrat e kërkuara në Republikën e Shqipërisë dhe na lejojë ne ta tregtojmë këtë mall brenda vendit për përdorim human, theksojmë se marrëdhënie tregtare është prokurimi publik.*

*4. Arsyetimi tjetër lidhet drejtpërdrejt me të parin, pasi ndër vite ISHP ka bërë të njëjtën analizë për Karbonit Aktiv dhe AK nuk ka ngritur ndonjëherë këtë pretendim që kjo analizë ë është e paplotë për fituesit e viteve më parë (kërkojmë nga ju të verifikohen fletë-analizat e dorëzuara nga operatorët fitues për vitet 2021-2020-2019-2018-2017). Analizën e ISHP ky AK e ka pranuar gjithmonë pasi në Republikën e Shqipërisë është 1 vetmi autoritet i specializuar sikurse thekson edhe Ministria e Shëndetësisë. Kjo pasi AK nuk mund të dalë sipër autoriteteve që kanë të drejtë të shprehen lidhur më parametrat që plotëson ky produkt dhe të marrë kompetenca që si takojnë duke u shprehur mbi ISHP dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Thënë kjo AK ka vepruar në mënyrë të qëllimshme duke përdorur këtë arsyetim të pa bazë dhe në kundërshtim të hapur me veten dhe autoritetet përgjegjëse të përcaktuar me ligj, pasi qëllimi i tyre është te gjenin një shkak për skualifikimin e operatorit tonë ekonomik. Për sa më sipër ndihemi të diskriminuar dhe të trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga AK dhe për këtë arsye ju si KPP duhet të merrni masa sipas ligjit ne fuqi. 5. Arsyetimi tjeter është*

*një vendim Nr. 888/2022, date 14.09.2022, Nr. Prot 1779/6, faqja 8-te, ju si KPP thoni qartë se citojmë : "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin c kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustifikuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar".*

*Mbështetur në sa më sipër laboratori i vetëm i cituar me emër nga AK është Instituti i Shëndetit Publik (sepse analizën e ISHP ka pranuar gjithmonë pasi në Republikën e Shqipërisë është i vetmi autoritet i specializuar sikurse thekson edhe Ministria e Shëndetësisë) ndërkohë për laboratorët e tjerë AK nuk na ka referuar asnjë laborator konkret. Thënë kjo mbështetur edhe në vendimin e KPP të sipërcituar ne i jemi referuar laboratorit të përmendur me emër nga AK dhe mbi të gjitha një laboratori që njihet me ligj në Republikën e Shqipërisë dhe që AK e ka pranuar në çdo procedure prokurimi me objekt "Blerje kimikate" dhe "Blerje Karbon Aktiv".*
*Kurse pikërisht në këtë procedure pas 28 ditësh vlerësimi të ofertave ngrihet ky pretendim, duke marrë kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoriteti i vetëm që jep leje për biocidet që plotësojnë parametrat që duhet të tregtohen në vend me qëllim final përdorimin human.*
*6. Arsyetimi i fundit lidhet me mostrën që në kemi dorëzuar ditën e hapjes së ofertave, datë 01.08.2023 ne baze te kriterit:*
*8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si me poshtë: 1.Karbon Aktiv*
*Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*
*Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.*

*Datën e hapjes së ofertave ne kemi dorëzuar mostrën e mallit objekt prokurimi. Mostra që operatorët ekonomikë dorëzojnë i nënshtrohet analizave të AK, se ndryshe për çfarë arsye kërkohet?! Mbështetur në këtë fakt për sa kohë AK nuk ka ngritur si pretendim për skualifikim faktin së mostra nuk i përmbushte parametrat e kërkuara atëherë mostra ka rezultuar brenda parametrave të kërkuara AK dhe AK qëllimisht ka anashkaluar këtë fakt duke kërkuar arsye të paqena në një analizë që ligjërisht njihet nga Republika e Shqipërisë dhe përmbush të gjitha kushtet që institucionet përgjegjëse ( Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP) kanë vendosur për të kualifikuar një biocid sipas parametrave ose jo. Kërkojmë përsëri që ankesa jonë të shihet me përparësi dhe të pranohet pasi AK qëllimisht ka vendosur të favorizoje hapur Operatorin Ekonomik "2AT" dukshëm e dallueshme nga kriteret e vendosura dhe gjithë arsyetimi që i ka bërë skulifikimit tonë si operator dhe argumenteve që ka vënë për mbrojtje të veprimeve të saj. Kërkojmë nga ana juaj të ndalohet kjo tendencë në rritje e këtyre autoriteteve kontraktore të cilat hapur favorizojnë operatorë të caktuar për vite më radhë dhe shpikin Kritere dhe argumente për skualifikim pa bazë ligjore në funksion të interesave të dyshimta, duke diskriminuar hapur operatorët e tjerë pjesëmarrës, si rasti jonë, që shpesh gjendemi në situata absurde ku ankesat to mbeten të pa përkrahura nga asnjë*

*institucion ankimues edhe pse janë të lidhur drejtpërdrejtë 10 interesin publik dhe rëndojnë në buxhetin e shtetit.*
*Këto veprime dhe mosveprime të autoriteteve të tilla kontraktore i kanë kthyer procedurat e prokurimit publik në procedura pa garë pasi askush nuk arrin të garojë dhe fitojë mbi operatorin që favorizon hapur AK për vite me radhë. Nëse doni fakte për sa më sipër jemi të gatshëm t'ia parashtojmë.*"

II.10. Në datën 08.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2196 prot., e operatorit ekonomik "W.Center" SHPK, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi dhe kulifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "2AT" SHPK konkretisht duke pretenduar: "*Në datën 29/06/2023, në sistemin e prokurimit elektronik është publikuar procedura e prokurimit me objekt: "Blerje karbon aktiv për UKT sh.a".*

*"Në datën 28.08.2023 është publikuar në SPE vlerësimi i ofertave nga ku ka rezultuar se oferta e paraqitur nga ana jonë është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:*

*-Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "W.CENTER" sh.p.k me oferte 51.783.370 (pesedhjete e nje milion e shtateqind e tetedhjete e tre mije e treqind e shtatedhjete) leke pa TVSh Komisioni i Vlerësimit te Ofertave ne mbeshtetje te nenit 80, neni 9213 te Ligjit 16212020, date 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", VKM-se nr.285, date 19.05. 2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar neni 82 si dhe dokumenteve të tenderit te miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vleresimin e ofertes se paraqitur nga ky operator ekonomik nga te cilet rezulton si me poshte vijon:*
*Se pari AK ka kerkuar ne kushtet e veçanta te kualifikimit, pika 5, si me poshte vijon:*
*5 .Operatori ekonomik duhet te paraqese flete analizen e parametrave te sigurise sipas (S SH EN 12903: 2009) te analizuara ne Institutin e Shëndetit Publik ose laboratore kombetare te akredituar sipas legjislacionit ne fuqi ose laborator ndërkombetare te akredituara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne sistemin e prokurimeve elektronike te paraqitur, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave veren se operatori ekonomik i sipercitur ka paraqitur flete analize te leshuar nga Instituti i Shendetit Publik dhe Certifikatë analize te leshuar nga prodhuesi SICAV, dokument ky ne te cilin deklarohet qe analizat jane kryer prane laboratorit te akredituar BIOSAN, por nuk eshte paraqitur flete analiza per komponentet e analizuar e leshuar nga ky laborator. Komisioni i Vleresimit te Ofertave ju ben me dije se, ne flete analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk eshte ne përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk jane te analizuara te gjitha komponentet e kerkuara ne dokumentet standarde te tenderit. Autoriteti Kontraktor ka specifikuar ne kriterin e sipercituar, qe flete analiza duhet te jete ne perputhje me standardin S SH EN 12903:2009, ku duhet te jene te analizuara te gjithe komponentet e kerkuar, si rrjedhoje u eshte lene hapesire te gjithe operatoreve ekonomike pjesemarres qe flete analiza e kerkuar te kryhet prane Institutit te Shendetit Publik dhe pjesa e komponenteve qe nuk kryhen nga ISHP, te kryhen prane laboratoreve kombëtar nderkombëtar te akredituar. Operatori ekonomik "W.Center" ka paraqitur vetem flete analizen e kryer prane ISHP, duke mos i plotesuar te gjithe komponentet e kerkuar për tu analizuar, e cila eshte e paplote. Operatoret Ekonomike jane te*

*detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i pare i interesuar eshte operatori ekonomik i cili e pergatit oferten ekonomike ne perputhje me kuadrin logjor ne fuqi dhe nga ana tjeter eshte autoriteti kontraktor i cili perzgjedh operatorin ekonomik qe plotëson të gjitha kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit, si dhe qe ka pergatitur oferten ne perputhje me kriteret e kualifikimit te percaktuara në DST. Komisioni i Vleresimit te Ofertave nga shqyrtimi i kesaj oferte ne mbeshtetje te nenit 80, neni 92/3 te Ligjit 162/2020, date 23.12.2020, per "Prokurimin Publik", dhe në mbeshtetje te VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik' Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall te pavlefshme kete oferte pasi nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit.*

*Në datën 01.09.2023 është publikuar "FORMULARI 1 NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)". Në lidhje me skualifikimin e ofertës tonë nuk jemi dakord dhe po paraqesim në vijim argumentet tona.*

*1. Në përmbushje të kriterit të parashikuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 5, ne kemi paraqitur për këtë procedurë prokurimi dy dokumente themelore:*

*Raport -Analize Nr.37 datë 31/07/2023 lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik*

*Certificato di Analizi date 20/07/2023 nga SICAV spa.*

*Në lidhje me Raport Analizën e lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik, parametrat e analizuar janë në përputhje me specifikimet teknike të produktit dhe kjo nuk kundërshtohet as nga Autoriteti Kontraktor.*

*Për të vërtetuar përputhshmërinë e parametrave të tjerë, të cilat nuk analizohen nga Instituti i Shëndetit Publik, kemi paraqitur fletë analizën për parametrat që jane analizuar në laboratorin e akredituar BIOSAN srl, sipas Raportit të Provës Nr. 23LA01679, datë 07/06/2023.*

*Në lidhje me këtë fletë analizë do të ndalemi në dy momente kryesore:*

*Së pari, parametrat e paraqitura janë në përputhje me parametrat teknike të produktit që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor dhe ky fakt nuk kundërshtohet as nga ky i fundit. Pra, Autoriteti Kontraktor, është i garantuar se produkti i ofruar është në përputhje me kërkesat teknike të produktit të kërkuar dhe ka patur mundësinë që të bëjë vlerësim teknik të parametrave bazuar në këtë fletë analizë të paraqitur. Pra, nga pikëpamja përmbajtjesore, ne kemi paraqitur të dhëna të plota në mënyrë që AK të gjykonte përputhshmërinë e produktit të ofruar me atë të kërkuar.*

*Së dyti, nga pikëpamja formale, Autoriteti Kontrakto ka vendosur të s'kualifikoje ofertën e paraqitur nga ana jonë për shkak se fleta e analizës është paraqitur nga prodhuesi SICAV spa dhe jo drejtpërdrejtë nga laboratori i akredituar BIOSAN srl. Pra, pa kundërshtuar përmbajtjen dhe thelbin e dokumenteve të paraqitura, AK ka kërkuar që fleta e analizës duhej të paraqitej nga laboratori i akredituar drejtpërdrejtë.*

*Një pretendim i tillë është në kundërshtim me kriterin e vendosur në pikën 5 të kritereve të veçanta të kualifikimit pasi në këtë kriter thuhet:*

*"5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurise sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtarë të akredituara."*

*Në këtë kriter në asnjë në asnjë pjesë të tij nuk thuhet se duhet të paraqitet fleta analiza e parametrave të sigurisë të lëshuar nga një laboratorë i akredituar por thuhet qartësisht se duhet të paraqitet një fletë analizë ku parametrat e cituar të jenë të analizuar në një laborator i akredituar. Në përmbushje të këtij kriteri, parametrat e cituar janë analizuar në një laborator të akredituar siç është "BIOSAN" srl. Në këto kushte, prodhuesi "SICAV" spa me të gjitha kompanitë që bashkëpunon harton fletën e analizës sipas parametrave të produktit që ai ka analizuar pranë laboratorit të akredituar "BIOSAN" srl. Midis prodhuesit SICAV spa dhe laboratorit të akredituar "BIOSAN" srl ka një marrëdhënie e cila qëndron jashtë marrëdhënies që "SICAV" spa ka me operatorin ekonomik që ka paraqitur një ofertë në këtë procedurë prokurimi. Prodhuesi "SICAV" spa është ai i cili analizon produktet e veta dhe na vendos në dispozicion analizën e parametrave të produktit bazuar në analizën e bërë paraprakisht pasi një gjë e tillë nuk mund të bëhet drejtpërdrejtë nga ana jonë. Detyrimi jonë si operatorë ekonomik për të përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 5 ka qenë që të garantohemi se analiza e parametrave të jetë bërë në një laborator të akredituar dhe për këtë ne kemi kryer të gjitha veprimet që kemi patur mundësi që të garantojmë Autoritetin Kontraktor duke paraqitur në fletë analizë të dhëna të detajuara sa i takon laboratorit ku është kryer analizimi i parametrave:*
*Emri i Laboratorit te Akredituar: BIOSAN srl*
*Raporti i Testit nr.23LA01679*
*Data:07/06/2023*

*Nëse Autoriteti Kontraktor kishte ndonjë dyshim në lidhje me analizimin e këtyre parametrave, i kishte të gjitha mundësitë që të bënte verifikimet përkatëse si pranë prodhuesit "SICAV" spa edhe pranë Laboratorit të Akredituar "BIOSAN" srl.*
*Në nenin 88 të VKM nr.285, datë 1910512021 parashikohet: "Nëse është e nevojshme Komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal".*
*Ky veprim nuk është kryer nga AK dhe në këtë pikë, qëndrimi i Autoritetit Kontraktor është me dy standarde pasi në lidhje me një operator tjetër pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi (Albania Distribution chemicals), edhe pse nuk është paraqitur një dokument që të vërtetojë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar ka insistuar që të kërkojë një sqarim tek rastësi, është i njëjti si në rastin tonë, "SICAV" spa. Pra, Autoriteti i kishte të gjitha mundësitë që bazuar në nenin 82 të kërkonte sqarime nga prodhuesi "SIVAC" spa që t'i vendoste në dispozicion fletën e analizës nr.23LA01679 e cila është përcaktuar në dokumentet e paraqitura ne SPE nga ana jonë.*

*Nisur nga arsyeja e skualifikimit, ne kemi kontaktuar menjëherë prodhuesin "SICAV" spa dukej kërkuar që të na vendosë në dispozicion një kopje të raport analizës që është bërë pranë laboratorit të akredituar "BIOSAN" srl. Menjëherë, prodhuesi "SICAV" spa na ka dërguar Raport Analizën nr. 23LAO1679, datë 07/06/2023, pikërisht siç është përmendur*

*edhe në Certifikatën e Analizës që është hartuar nga SICAV spa në përputhje me këtë fletë analizë. SIÇ duket nga përmbajtja e të dy dokumenteve, parametrat e karbonit aktiv janë njësoj në të dy dokumentet dhe për këtë arsye kërkojmë nga ana juaj që të merrni në konsideratë fletën e analizës bashkëlidhur kësaj ankese për shkak se përmbajtja e saj është e njëjtë me përmbajtjen e dokumentit që kemi dorëzuar në SPE dhe kjo fletë analizë është kryer që në datën 07/06/2023, disa ditë përpara se të publikohej procedura e prokurimit.*

*Në nenin 26 te VKM nr.285, datë 1910512021 përcaktohet se:*

*Autoriteti enti kontraktor pranon nje dokument te leshuar nga i njëjti institucion ose pale e trete dhe qe ka te njejtin informacion me ate te paraqitur ne proceduren e zhvilluar ne menyre elektronike.*

*Në këto kushte, fleta e analizës e lëshuar nga laboratori akredituar "BIOSAN" srl ka të njëjtën përmbajtje me fletën e analizës së hartuar nga vetë "SICAV" spa dhe duhet të merret në konsideratë nga ana juaj në përmbushjen e kriterit në fjalë.*

*Referuar ligjit të prokurimit publik, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, rezulton, se për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku ofertuesi shprehet se oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit. Perveç sa argumentuam me siper, për përmbushjen e këtij kriteri ne kemi dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Vendosja e kritereve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*
*Pjesa II Kriteret e Përzgjedhjes Kualifikimit, A: Deklaratë, Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:*
***Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit***
***A: DEKLARATË***
***Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:***

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga* | *Po [ ] Jo [ ]* |

| | |
|---|---|
| *Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.* | |

*Nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur dhe Shtojcës Nr.8 ne kemi garantuar AK se i përmbushim të gjitha specifikimet teknike siç udhëzohet në dokumentet e tenderit dhe e provojmë këtë nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe atij që mund të kërkohet nga ana e Autoritetit Kontraktor ashtu siç parashikohet edhe në nenin 82/2 të ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik".*

*"Në çdo kohe gjate procedures autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kerkoje ofertuesve dhe kandidateve sqarime dhe dokumentet mbeshtetese per keto sqarime kur kjo eshte e nevojshme per te garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

*Në lidhje me ofertën e paraqitur nga ana e operatorit "2AT" ShPK, ofertë e cila është kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor dyshojmë se dokumentacioni i paraqitur në lidhje me fletën e analizës së produktit nga prodhuesi nuk është i saktë dhe se prodhuesi i produktit nuk ka një laborator të akredituar. Në keto kushte kërkojmë nga ana juaj që të rishikoni dokumentacionin e paraqitur nga operatori në fjalë dhe në rast se konstatohen dyshimet tona të skualifikoni ofertën e paraqitur prej tij.*
*Në përfundim të argumentimeve të paraqitura në kete ankesë, kërkojmë: - Anulimin e vendimit te komisionit të ofertave si të pambështetur në prova dhe në ligj dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë. - Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori i kualifikuar "2AT" ShPK për shkak të mosplotësimit të kritereve të veçanta të kualifikimit.*"

II.11. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2196/2 prot., datë 11.09.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe pretendimet mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "2 AT" SHPK.

II.12. Me datë 13.09.2023 përmes shërbimit postar protokolluar me tonën nr. 2196/3 prot., datë 15.09.2023, si dhe me datë 15.09.2023 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar me tonën nr. 2196/4 prot., datë 15.09.2023, operatori ekonomik "2AT" SHPK ka paraqitur pranë KPP-së formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" duke argumentuar si më poshtë vijon:
*"Firma "2 AT " Shpk me NIPT K14019001 H , ka marre pjese ne proceduren e prokurimit me objekt "Blerje Karbon Aktiv për UKT " sh.a, date 0110812023 me Nr. Ref-73920-06-29-2023 ku jemi kualifikuar si operator ekonomik duke permbushur te gjitha kriteret sipas*

*dokumenteve standarde te tenderit dhe kemi marre njoftim ne daten 01/09/2023 ne sistemin elektronik Formular i njoftimit te operatoreve ekonomike e suksesshëm ne marreveshjen kuader paraprak referuar VKM 807 date 11.06.2016*
*Firma 2 AT ShPK kundershton pretendimet e operatorit ekonomik "W.Center" SHPK ne ankesen e bere nga kjo firme me Numri i Protokollit Nr.2196/2 prot., Data 11/09/2023. Firma 2 AT ShPK, NIPT K14019001H e vlereson te drejte skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "W.Center" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar .*
*Firma '2 AT" Shpk me NIPT K14019001H e vlereson te drejte skualifikimin e ketij OE pasi ai nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika 5*
*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara.*

*Sipas Ligjit te Prokurimit Publik :*
*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.*
me kontratat e ngjashme, KPP e gjykon të gabuar argumentimin e KSHA-së, pasi së pari baza ligjore të cilës i referohet KSHA (neni 39 pika 5 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për prokurimin Publik") lidhet me procedurat e prokurimit të llojit punë publike ndërsa në rastin konkret referuar objektit të prokurimit si dhe të dhënave kryesore të procedurës jemi para procedurës së prokurimit publik të llojit mall. Së dyti nisur nga përmbajtja e kriterit të hartuar nga autoriteti kontraktor, KPP vëren se për operatorët ekonomikë e rëndësishme është që të plotësojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor për kontratat e ngjashme pavarësisht nëse kjo e fundit është e lidhur me subjektet publike apo private, mjafton që vlera e kontratave apo zërave që konsiderohen të ngjashme (të lidhura me subjekte publike dhe private të përllogaritur së bashku) të plotësojë kërkesat e autoriteti kontraktor, në ndryshim nga argumentimi i gabuar i KSHA-së sipas të cilit vlera e realizimit të kontratave të ngjashme do të konsiderohej e vlefshme nëse "*Operatori ekonomik ankimues do të plotësonte kriterin e sipërcituar me njërën nga pikat (a) ose (b) duke qenë se secila pune e ngjashme (sektori publik privat) përllogaritet më vete.*'' KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemicals" SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen, se operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin: "*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara..*" KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 5 të modifikuar "Formulari i specifikimeve teknike" autoriteti kontraktor ka parashikuar: **Në Shtojcën Nr.5 specifikimet teknike i janë referuar standardit EN12902/2004 :**
**Shtojca 5.**

***SPECIFIKIMET TEKNIKE***

**Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur**

Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.

Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të përmbushin parametrat si më poshtë :

| Nr | Parametrat | Njësia matjes | Specifikimet | Metoda |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Densiteti dukshëm | Kg/$m^3$ | 200 – 750 | EN12902/2004 |
| 2 | Granulometria <150m | % në m/m | min. 95 | EN12902/2004 |
| 3 | Hiri | % në m/m | max. 15 | EN12902/2004 |
| 4 | Lagështia(ne ambalazhim ) | % në m/m | max. 5 | EN12902/2004 |
| 5 | Nr Jodit | mg/g | min 900 | EN12902/2004 |
| 6 | Substancat e tretshme ne uje | % në m/m | max. 3 | EN12902/2004 |
| 7 | Zinku (Zn) | % në m/m | max. 0.002 | EN12902/2004 |
| 8 | Arseniku (As) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 9 | Kadmiumi (Cd) | mg/kg | max. 5 | EN12902/2004 |
| 10 | Krom (Cr) | mg/kg | max.50 | EN12902/2004 |
| 11 | Merkur (Hg) | mg/kg | max. 1 | EN12902/2004 |
| 12 | Nikel (Ni) | mg/kg | max.20 | EN12902/2004 |
| 13 | Plumb (Pb) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 14 | Antimoni ( Sb) | mg/kg | max. 5 | EN12902/2004 |
| 15 | Selenium (Se) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 16 | Jone Cianur ($CN^-$) | mg/kg | max.50 | EN12902/2004 |
| 17 | PAH | mg/kg | max. 0.2 | EN12902/2004 |

Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902: 2006.

**BËHET :**

**Shtojca 5.**

***SPECIFIKIMET TEKNIKE***

**Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur**

Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore  dhe  aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.

Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të përmbushin parametrat si më poshtë :

| **Nr.** | **Parametrat** | **Njësia matjes** | **Specifikimet** | **Metoda** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Densiteti  dukshëm | Kg/m$^3$ | 200 – 750 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 2 | Granulometria <150m | % në m/m | min. 95 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 3 | Hiri | % në m/m | max. 15 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 4 | Lagështia(ne ambalazhim ) | % në m/m | max.  5 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 5 | Nr Jodit | mg/g | min 900 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 6 | Substancat e tretshme ne uje | % në m/m | max. 3 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 7 | Zinku (Zn) | % në m/m | max. 0.002 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 8 | Arseniku (As) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 9 | Kadmiumi (Cd) | mg/kg | max.  5 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 10 | Krom (Cr) | mg/kg | max.50 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 11 | Merkur (Hg) | mg/kg | max.  1 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 12 | Nikel (Ni) | mg/kg | max.20 | **SSH EN 12902: 2006** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | Plumb (Pb) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 14 | Antimoni ( Sb) | mg/kg | max. 5 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 15 | Selenium (Se) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 16 | Jone Cianur ($CN^-$) | mg/kg | max.50 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 17 | PAH | mg/kg | max. 0.2 | **SSH EN 12902: 2006** |

Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902: 2006.

III.2.2. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve të tenderit "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim" pika 5, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

***5** .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*

III.2.3. Në përmbushje të kriterit me sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

*-Raport analizë nr. 34 me nr. 621/1 prot., datë 10.07.2023 lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik ku për karbonin aktiv pluhur sipas kësaj flet - analize rezultojnë të dhënat si më poshtë:*

| KARBON AKTIV PLUHUR (mg/kg) | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Plumbi (Pb) | 0.3 | Max. 10 | S SH EN 12903:2003 |
| 2 | Kadmiumi (Cd) | n.d | Max. 5 | S SH EN 12903:2003 |
| 3 | Kromi (Cr) | 0.5 | Max. 50 | S SH EN 12903:2003 |
| 4 | Nikeli (Ni) | 1.4 | Max. 20 | S SH EN 12903:2003 |

III.2.4. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin më sipër autoriteti kontraktor ka argumentuar se:

*"Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon:*

*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur fletë analize nga Instituti i shëndetit publik .*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuara të gjitha komponentët e kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Autoriteti Kontraktor ka : specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standardin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar. Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e cila është e paplotë.*

*Së dyti në formularin e ankesës operatori ekonomik pretendon laboratori i vetëm i cituar me emër nga AK është Instituti i Shëndetit Publik, ndërkohë për laboratorët e tjerë AK nuk ka referuar asnjë laborator konkret.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se, referuar kriterit të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, ka sqaruar se fletë analiza që duhej të paraqitej nga operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të përmbajë parametrat e sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009), të cilat mund të jenë të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*

*Komisioni i shqyrtimit te ankesave ju bën me dije se Autoriteti kontraktor lidhur me kriterin e Sipërcituar, duke mos cituar emra për laboratorët kombëtarë ose ndërkombëtarë të akredituar, u ka lënë hapësirë operatorëve ekonomik pjesëmarrës të bëjnë zgjedhjet e tyre për të plotësuar zërat e analizuar të parametrave të sigurisë që nuk mbulohen nga Instituti i Shëndetit Publik në laboratorët që ata dëshirojnë me qëllim përmbushjen e kriterit të kërkuar nga Autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, por me kushtin që të jenë të akredituar për të përmbushur standardin S SH EN 12903: 2009.*

*Komisioni i shqyrtimit të Ankesave sqaron se, në rast se operatori pjesëmarrës do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 17/1 e LPP, ku parashikohet se: Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, për shirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*

*Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës , do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Sqarojmë se përderisa operatori ekonomik Albania Distribution Chem sh.p.k nuk e ka ushtruar të drejtën e kërkesës për sqarim apo të drejtën e ankimit brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e APP-së lidhur me vendosjen e kritereve te veçanta të kualifikimit atëherë është i detyruar që në fazën e vlerësimit të ofertave të plotësojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST. Pra në vlerësimin e një procedure prokurimi vlerësohet vetëm mbi bazë të kritereve të kërkuara në DST.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme ekonomiko-financiare, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave e gjykon të saktë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron."*

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se*: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*
Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:*" 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që "***5** .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara."* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se ky i fundit nuk e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontrakor, pasi Raport analiza nr. 34 me nr. 621/1 prot., datë 10.07.2023, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik, që ka paraqitur operatori ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemicals" SHPK, nuk i ka të paraqitura të gjithë treguesit siç autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit. Nisur nga përmbajtja e kriterit të hartuar nga autoriteti kontrakor, KPP vëren, se për operatorët ekonomikë është lënë opsionale mundësia e paraqitjes së fletë analizës nga ISHP ose subjekte private kombëtare apo ndërkombëtare të akredituara, mjafton që ajo të përmbajë treguesit e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Nga verifikimet rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur vetëm fletë - analizën e ISHP-së, e cila nuk i përmban të gjithë treguesit e kërkuar nga autoriteti kontraktor, e rrjedhimisht duke sjellë edhe mosplotësimin e kriterit më sipër. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim", pika 5, pasi në përmbushje të kriterit më sipër ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport - analizë nga ISHP, e cila nuk i përmban të gjithë treguesit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga

autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Komisioni risjell në vëmendje faktin, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime mbi kriteret për kualifikim apo specifikimet tenike të hartuara nga autoriteti kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural për paraqitjen e ankesës për dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 110 të lex specialis apo kërkesën për sqarime pranë autoritetit kontraktor, garanci procedurale këto që i ofrohen operatorëve ekonomikë me qëllim vënien në vend të shkeljes së pretenduar dhe përmbushjen e interesit të tyre të ligjshëm. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në "kriteret e veçanta të kualifikimit" "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim", pika 5.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemicals" SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemicals" SHPK mbi pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, ato nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi në procesin adminsitrativ, pasi sipas arsyetimit të KPP gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK do të vazhdojë të mbetet e skualifikuar dhe bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt - prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK SHPK, mbi ofertat e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurë, nuk do të merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK me pretendimin se nuk përmbush: "*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara.."* KPP vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 5 të modifikuar "Formulari i specifikimeve teknike" autoriteti kontraktor ka parashikuar: **Në Shtojcën Nr.5 specifikimet teknike i janë referuar standardit EN12902/2004 :**

**Shtojca 5.**

***SPECIFIKIMET TEKNIKE***

**Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur**

Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.

Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të permbushin parametrat si më poshtë :

| **Nr** | **Parametrat** | **Njësia matjes** | **Specifikimet** | **Metoda** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Densiteti dukshëm | $Kg/m^3$ | 200 – 750 | EN12902/2004 |
| 2 | Granulometria <150m | % në m/m | min. 95 | EN12902/2004 |
| 3 | Hiri | % në m/m | max. 15 | EN12902/2004 |
| 4 | Lagështia( ne ambalazhim ) | % në m/m | max. 5 | EN12902/2004 |
| 5 | Nr Jodit | mg/g | min 900 | EN12902/2004 |
| 6 | Substancat e tretshme ne uje | % në m/m | max. 3 | EN12902/2004 |
| 7 | Zinku (Zn) | % në m/m | max. 0.002 | EN12902/2004 |
| 8 | Arseniku (As) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 9 | Kadmiumi (Cd) | mg/kg | max. 5 | EN12902/2004 |
| 10 | Krom (Cr) | mg/kg | max.50 | EN12902/2004 |
| 11 | Merkur (Hg) | mg/kg | max. 1 | EN12902/2004 |
| 12 | Nikel (Ni) | mg/k | max.20 | EN12902/20 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | g | | 04 |
| 13 | Plumb (Pb) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 14 | Antimoni ( Sb) | mg/kg | max. 5 | EN12902/2004 |
| 15 | Selenium (Se) | mg/kg | max.10 | EN12902/2004 |
| 16 | Jone Cianur ($CN^-$) | mg/kg | max.50 | EN12902/2004 |
| 17 | PAH | mg/kg | max. 0.2 | EN12902/2004 |

Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902: 2006.

**BËHET :**

**Shtojca 5.**

***SPECIFIKIMET TEKNIKE***

**Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur**

Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.

Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të permbushin parametrat si më poshtë :

| **Nr** | **Parametrat** | **Njësia matjes** | **Specifikimet** | **Metoda** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Densiteti dukshëm | $Kg/m^3$ | 200 – 750 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 2 | Granulometria <150m | % në m/m | min. 95 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 3 | Hiri | % në m/m | max. 15 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 4 | Lagështia(ne ambalazhim ) | % në m/m | max. 5 | **SSH EN** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 12902: 2006 |
| 5 | Nr Jodit | mg/g | min 900 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 6 | Substancat e tretshme ne uje | % në m/m | max. 3 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 7 | Zinku (Zn) | % në m/m | max. 0.002 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 8 | Arseniku (As) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 9 | Kadmiumi (Cd) | mg/kg | max. 5 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 10 | Krom (Cr) | mg/kg | max.50 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 11 | Merkur (Hg) | mg/kg | max. 1 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 12 | Nikel (Ni) | mg/kg | max.20 | **SSH EN 12902: 2006** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | Plumb (Pb) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 14 | Antimoni ( Sb) | mg/kg | max. 5 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 15 | Selenium (Se) | mg/kg | max.10 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 16 | Jone Cianur ($CN^-$) | mg/kg | max.50 | **SSH EN 12902: 2006** |
| 17 | PAH | mg/kg | max. 0.2 | **SSH EN 12902: 2006** |

Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902: 2006.

III.4.2. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve të tenderit "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim" pika 5, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

***5*** *.Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laboratorë ndërkombetare të akredituara.*

III.4.3. Në përmbushje të kriterit me sipër operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

*-Raport analizë nr. 37 me nr. 707/1 prot., datë 31.07.2023 lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për subjektin "Chimica Francesco D'Agostino" S.p.A ku për karbonin aktiv pluhur sipas kësaj flet analize rezultojnë të dhënat si më poshtë:*

| Nr. | Indekset Analitike | Rezultati i mostrës së analizuar | Limiti (në mg/kg ) | Metoda e analizës |
|---|---|---|---|---|
| KARBON AKTIV PLUHUR (mg/kg) | | | | |
| 1 | Plumbi (Pb) | n.d. | Max. 10 | S SH EN 12903:2003 |
| 2 | Kadmiumi (Cd) | n.d. | Max. 5 | S SH EN 12903:2003 |
| 3 | Kromi (Cr) | 0.2 | Max. 50 | S SH EN 12903:2003 |
| 4 | Nikeli (Ni) | n.d. | Max. 20 | S SH EN 12903:2003 |

*Shënim: Raport Analiza vlen vetëm për mostrën/at e sjellë/a dhe të analizuar/a në laboratorë.*
*n.d – nuk detektohet.*

- Raport analizë e datës 20.07.2023 e kompanisë Sicav s.p.a e përkthyer dhe noterizuar me vërtetim përkthimi nr. Rep 3052, datë 26.07.2023.

III.4.4. Në kthimin e përgjigjes në lidhje me këtë pretendim autoriteti kontraktor ka argumentuar:

"*[...]Operatori ekonomik " W-CENTER" sh.p.k nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor kundërshton skualifikimin e tij nga procedura objekt ankimimi.*
*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim procesverbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO vëren se operatori ekonomik është skualifikuar me arsyetimin e mëposhtëm:*
*Se pari: AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon:*
*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombëtare të akredituara.*
*Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur fletë analize të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Çertifikatë analize të lëshuar nga prodhuesi SICAV, dokument ky në të cilin deklarohet që analizat janë kryer pranë laboratorit të akredituar BIOSAN, por nuk është paraqitur fletë analiza për komponentët e analizuar e lëshuar nga ky laborator.*
*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit. Autoriteti Kontraktor ka specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standardin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuara të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar.*
*Operatori ekonomik "W. Center" ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP, duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e cila është e paplotë.*
*Në formularin e ankesës operatori ekonomik pretendon se në përmbushje të pikës 5 ë kritereve të veçanta të kualifikimit, parametrat e kërkuar janë analizuar në një laborator të*

*akredit判 siç është "BIOSAN srl". Prodhuesi "SICAV" spa me të gjithë kompanitë që bashkëpunon harton fletë analizën sipas parametrave të produktit që ai ka analizuar pranë laboratorit të akredituar " BIOSAN" srl, marredhenia midis prodhuesit dhe laboratorit BIOSAN" srl, qëndron jashtë marrëdhënies që "SICAV" spa ka me operatorin ofertues Detyrimi ynë si operator ekonomik për të përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 5 ka qenë të garantohemi se analizat e parametrave të jenë bërë nga laborator të akredituar dhe për këtë ne kemi kryer të gjitha veprimet që kemi patur mundësi që të garantojmë Autoritetin kontraktor duke paraqitur në flete analizë të dhënat të detajuara sa i takon laboratorit ku është kryer analizimi i parametrave.*

*Nëse AK kishte ndonjë dyshim në lidhje me analizimin e këtyre parametrave, i kishte të gjithë mundësitë që të bënte verifikimet përkatëse si pranë prodhuesit "SICAV" spa edhe pranë Laboratorit të akredituar 'BIOSAN" srl.*
*Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se, në dokumentet e paraqitura në SPE nga operatori ekonomik ankimues, referuar pikës 5, është dorëzuar një fletë analize nga distributor zyrtar SICAV spa, për analiza të kryera pranë Laboratorit të akredituar BIOSAN srl. Arsyetimi i komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues ka të bëjë me faktin që operatori ekonomik nuk ka paraqitur fletë analizë nga një laborator i akredituar ne këtë rast laboratori "BIOSAN" srl, por ka paraqitur fletë analizën që disponon distributori zyrtar për produktin që tregton. Në rastin konkret, dokumenti i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në pikën 5, të kritereve të veçanta të kualifikimit, në dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues mungon. Për sa i përket, pjesës ku operatori ekonomik ankimues shprehet që Autoriteti Kontraktor nëse kishte dyshime në lidhje me analizimin e parametrave, mund të bënte verifikimet e nevojshme, ju bëjmë me dije, se komisioni i vlerësimit te ofertave gjykon mbi dokumentet e paraqitura ne SPE*
*Autoriteti Kontraktor nuk e ka detyrimin t'u kërkojë operatorëve ekonomik pjesëmarrës shtimin e dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit për të përmbushur kriteret e kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Autoriteti Kontraktor (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet se e gjykon të nevojshme aso të dyshimtë mund të kërkojë verifikimin e dokumentacionit që është i paraqitur në SPE.*
*Komisioni i shqyrtimit te ankesave ju bën me dije se operatori ekonomik ofertues nuk i është përmbajtur dokumenteve standarde te tenderit.*
*Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron."*

III.4.5. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët *ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të*

*zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

III.4.6. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*”

III.4.7. Në nenin 40 pika 6 germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
*a) mostra të mlekeit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;"*

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë, se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Nisur nga arsyeja e skualifkimit të operatorit ekonomik ankimues, se ai nuk përmbush kriterin "*5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuara në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laboratorë ndërkombetare të akredituar",* përgjigjja e KSHA-së së autoritetit kontraktor, dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga parashtrimet e ankimuesit të paraqitura në ankesë dhe dokumentacioni shoqërues i ankesës, bashkëlidhur së cilës gjendet edhe Raporti i provës me nr. 23LA01678 datë 07.06.2023 i kompanisë "Biosan" s.r.l me porositës kompaninë Sicav s.p.a, vihet re se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar më sipër, sepse disa prej parametrave janë analizuar nga Instituti i Shëndetit Publik, për të cilët autoriteti kontraktor nuk ka shfaqur pretendime, ndërsa për pjesën tjetër të parametrave që nuk plotësohen nga fletë analiza e mësipërme e ISHP-së operatori ekonomik ankimues ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik certifikatën e analizës së prodhuesit "Sicav" s.p.a, e datës 20.07.2023, e përkthyer dhe noterizuar sipas vërtetimit të përkthimit nr. Rep 3052, datë 26.07.2023, duke dhënë indicie mbi plotësimin e kriterit në fjalë nga ana e tij dhe për t'a kthyer në vlerën e provës autoriteti kontraktor bazuar në nenin 92 pika 1 të *lex specialis* duhet të kërkonte sqarime nga operatori ekonomik ankimues. Në këtë rast autoriteti kontrakor me mosveprim ka shkelur nenin 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: "*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*" Autoriteti kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", t'i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë, në përmbushje të qëllimeve të *lex specialis* të parashikuara në nenin 2 të tij. Me mosveprim autoriteti kontraktor i ka cenuar operatorit ekonomikë mundësinë për të shteruar të gjitha alternativat e vënies në dispozicion të dokumenteve provuese (siç është në rastin konkret (Raporti i provës me nr. 23LA01678, datë 07.06.2023, i kompanisë Biosan s.r.l ) në mbështetje të dokumentit certifikatë e analizës së prodhuesit "Sicav" s.p.a, i datës 20.07.2023, i ngarkuar në sistem, i cili do t'i krijonte një panoramë më të qartë autoritetit kontraktor mbi përmbushjen apo jo të kriterit më sipër, pasi autoriteti kontraktor të njihej dhe vlerësonte mbi përmbajtjen e plotë të dokumentacionit. Duke qenë se autoriteti kontraktor referuar sistemit të prokurimit elektronik, informacionit të dërguar nga ai si pjesë e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe parashtrimeve të operatorit ekonomik ankimues, në kundërshtim me nenin 92, pika 1 të *lex specialis,* nuk i ka kërkuar sqarim operatorit ekonomik ankimues me qëllim që për përmbushjen e kriterit më sipër të gjykonte mbi përmbajtjen e analizave të ISHP të ngarkuara në sistem, si dhe mbi përmbajtjen e Raport provës me nr. 23LA01678, datë 07.06.20233, të kompanisë Biosan s.r.l, të cilën

operatori ekonomik ankimues e ka bashkëlidhur me ankesën e paraqitur, Komisioni gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK, mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "2AT" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik "2 AT" SHPK, për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. Akoma më tej, referuar shqyrtimit të mësipërm të KPP, operatori ekonomik "W.Center" SHPK do të kualifikohet, duke arritur kështu qëllimin e tij të ligjshëm, që është fitimi i kontratës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik "W.Center" SHPK., mbi ofertën e operatorit ekonomik "2AT" SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*",, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-73920-06-29-2023, me objekt: "Blerje karbon aktiv për UKT Sh.A", me fond limit 60,000,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "W.Center" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "W.Center" SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë "Albania Distribution Chemicals" SHPK dhe "W.Center" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**
**Anila Malaj**

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2023.10.12
05:27:42

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2023/10/12 16:05:40 +02'00'
7314652023101216053360020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*